



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1695/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Prime DB, shpk, me numër unik identifikues 810812885, me seli ne Prishtinë lagja “Bregu i Diellit-Princesha”, te cilën e përfaqësojnë avokatët Adelina P.Isufi dhe Fisnik A. Sogojeva”, me seli ne Prishtinë, ndaj debitorit Petrol Company shpk, me numër unik identifikues 810527195, me seli ne Prishtinë magjistrala Prishtinë-Fushë Kosovë, te cilin e përfaqësojnë avokatet Arianit Koci dhe Granit Vokshi, me seli ne Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesat e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2298/22 datë 30.10.2023, me datën 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e kreditorit Prime DB, me seli ne Prishtinë lagja “Bregu i Diellit-Princesha”, dhe ankesa e debitorit Petrol Company shpk, me seli ne Prishtinë magjistrala Prishtinë-Fushë Kosovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2298/22 i datës 30.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2298/22 dt.30.10.2023, ne pjesën e parë te dispozitivit të aktvendimit ka Aprovuar pjesërisht prapësimin debitorit Petrol Company shpk, me numër unik identifikues 810527195 dhe ka Anuluar pjesërisht Urdhrin përmbarimor P.nr.566/22 dtr.21.09.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Z. Mulhaxha, sa i përket shumës së detyrimit prej 3,746.5€ sipas faturës nr.2021/172 dt.27.12.2021, 2022/027 dt.27.02.2022, 2022/054 dt.27.04.2022, 2022/066 dt. 27.05.2022, 2022/080 dt.27.06.2022, si dhe ka përfunduar pjesërisht procedurën ne këtë çështje përmbarimore. Në pjesën e dytë te dispozitivit te aktvendimit ka Refuzuar si te pabazuar pjesërisht prapësimin e debitorit Petrol Company shpk, me numër unik identifikues 810527195 dhe ka lënë ne fuqi pjesën tjetër të Urdhrit përmbarimor P.nr.566/22 dt.21.09.2022, Përmbaruesi Privat Ilir Z. Mulhaxha për pjesën e detyrimit ne shumën prej 749.30€,

sipas faturës nr.2022/015 dt.27.01.2022, së bashku me kumatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.

Kundër këtij aktvendimi, kanë paraqitur ankesë përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse:

- Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, kundërshton aktvendimin e atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj si të bazuar ankesën e kreditorit, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj, ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi Urdhrin përmbartimor ndërsa ta detyroj debitorin të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.
- Debitori, përmes përfaqësuesve të autorizuar, pa precizuar bazat e veçanta ankimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta provoj ankesën e debitorit, aktvendimin e atakuar ta anuloj, urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj dhe ta obligoj kreditorin të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përgjigje në ankesë kanë dhënë të autorizuarit e debitorit, përmes së cilës i kontestojnë pretendimet e kreditorit, me propozim që gjykata ta refuzoj ankesën e kreditorit, si të pabazuar.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesat e kreditorit dhe debitorit janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Prime DB”, shpk, me numër unik identifikues 810812885, me seli në Prishtinë lagja “Bregu i Diellit-Princesha”, me datën 21.09.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “Petrol Company” shpk, me numër unik identifikues 810527195, me seli në Prishtinë Magjistrala Prishtinë-Fushë Kosovë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.2021/172 dt.27.12.2021, 2022/015 dt.27.01.2022, 2022/027 dt.27.02.2022, 2022/054 dt.27.04.2022, 2022/066 dt.27.05.2022, 2022/080 dt.27.06.2022. Përmbartuesi Privat Ilir Z. Mulhaxha, nga Prishtina, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.566/22 të datës 21.09.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër të borxhit nga faturat kreditorit t’i paguaj shumën në total prej 4,495.80 euro, me kumatëvonesë prej 8% nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 06.10.2022, me arsyetimin se faturat nr.2021/172 dt.27.12.2021, 2022/015 dt.27.01.2022, 2022/027 dt.27.02.2022, 2022/054

dt.27.04.2022, 2022/066 dt.27.05.2022, 2022/080 dt.27.06.2022, nuk i plotësojnë kushtet ligjore që dalin nga neni 29 par.3 i LPP si dhe neni 20 par.1.1.17 i U.A. nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, borxhi që kërkohet në këtë rast nuk ka bazë që në fillim të akumulohet ngase shërbimi nuk është ofruar përtej çdo pritshmërie, faturat nuk i janë dorëzuar debitorit sipas marrëveshjes dhe as nuk janë pranuar me rregull, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj ndërsa të detyrohet kreditori të paguaj shpenzimet e procedurës.

Ndaj prapësimin të debitorit, me datën 12.10.2022, kreditori ka parashtruar përgjigje, përmes së cilit kundërshton pretendimet e debitorit në prapësim se nuk i ka pranuar faturat, duke theksuar se kreditori ka lëshuar faturat dhe se debitori ka vepruar në keqbesim, ndërsa i njëjti ka pranuar faturën nr.2022/015 dt.27.01.2022, përmes postës elektronike me e-mailin e datës 27.01.2022 pranimin e të cilit e-mail se bashku me faturën e ka konfirmuar. Debitori nuk e konteston obligimin ndaj kreditorit, por tenton të zvarrit pagesën, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi ndërsa ta detyroj debitorin të paguaj shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2298/22 dt.30.10.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata thekson se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi me nr.2021/172 dt.27.12.2021, 2022/027 dt.27.02.2022, 2022/054 dt.27.04.2022, 2022/066 dt.27.05.2022, 2022/080 dt.27.06.2022, nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për të qenë dokumente të besueshme sepse nga këto fatura nuk mund të vërtetohet se janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori dhe me asnjë provë nuk është dëshmuar se të njëjtat janë dorëzuar tek debitori. Faturat nuk janë nënshkruar e as vulosur nga debitori dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbartim, ashtu që edhe gjykata në pajtim me nenin 12 par.2 të ligjit nr.05/L-118 ka përfunduar procedurën përmbartimore. Gjykata ka vendosur si në pikën e dytë të dispozitivit duke arsyetuar se fatura nr.2022/015 dt.27.01.2022 në bazë të cilës është lejuar përmbartimi, i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP, e njëjta faturë është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes e-mailit të datës 04.02.2022 ku është bërë edhe konfirmimi mbi pranimin e faturës për muajin Janar 2022. Gjykata vendosi të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor edhe sa i përket kamatës prej 8% dhe atë bazuar në nenin 382 të LMD. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e debitorit por ka gjetur se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i kësaj procedure e kjo sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal në bazë të cilës nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera por vetëm i elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi. Andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me

rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori nr.2021/172 dt.27.12.2021, 2022/027 dt.27.02.2022, 2022/054 dt.27.04.2022, 2022/066 dt.27.05.2022, 2022/080 dt.27.06.2022, por që këto fatura nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së sepse nuk janë të nënshkruara e as të vulosura nga debitori si dhe në shkresa të lëndës nuk ka prova se të njëjtat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori. Ndërsa sa i përket faturës nr.2022/015 dt.27.01.2022 në bazë të cilës është lejuar përmbarimi, edhe kjo gjykatë vlerëson se kjo faturë i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe se i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP, e njëjta faturë edhe nga kjo gjykatë konsiderohet se është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt pasi i njëjti përmes e-mailit të datës 04.02.2022 në ora 12:30 PM, konfirmon pranimin e faturës për muajin Janar 2022.

Në rastin konkret Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitave konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK dhe e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë ka analizuar pretendimet ankimore të kreditorit dhe debitorit, por se të njëjtat i vlerësoj si jo relevante për një vendosje ndryshe, andaj edhe i refuzoi si të tilla ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj. Dhomat e shkallës së dytë nuk ka mund të vërtetoj pretendimet ankimore të kreditorit se nga komunikimet elektronike dt.15.03.2022, 16.03.2022, debitori ka pranuar borxhin që rrjedh nga faturat përmbarimore. Ndërsa pretendimin ankimor të debitorit se pika II e aktvendimit të atakuar ka arsyetim të mangët, se forma e komunikimit ka ende mangësi në përdorim, kjo gjykatë nuk i pranoi si të bazuara, sepse nuk mund të mohohet kjo provë materiale, e-mail i datës 04.02.2022 që dëshmon se debitori konfirmon borxhin për muajin janar 2022 respektivisht faturën nr.2022/015 dt.27.01.2022. Gjithashtu kjo gjykatë vlerësoi se dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktvendimit, dhe se aktvendimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhomat e shkallës së dytë.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1695/23 me datë 02.05.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha